# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6872
E premte, 14 prill 2023
Çmimi 0.40 €


## Norvegjia dëbon 15 “oficerë rusë të inteligjencës”

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# KËRKOHET SHTYRJA E ZGJEDHJEVE NË VERI

FAQE 4



Edhe dhjetë ditë kanë mbetur deri në mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës, por ka shumë dilema nëse këto zgjedhje do të mbahen më 23 prill. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk ka miratuar listën e qendrave të votimit. Njohës të proceseve zgjedhore dhe përfaqësues nga opozita e kanë vlerësuar të vështirë organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike në veri të Kosovës nëse merret parasysh situata politike. Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se këto zgjedhje duhet të shtyhen

## PRESIDENTI I SHQIPËRISË BËN THIRRJE PËR ZGJEDHJE TË LIRA DHE PA KEQPËRDORIME



FAQE 3

## FILLON PROCESI PËR RISHIKIMIN E TEKSTEVE DHE MATERIALEVE MËSIMORE PËR KLASAT I-IX

FAQE 6



## AKTUALE



### MAVRAJ DËNON SULMIN NDAJ SYLËS: E KEMI ÇLIRUAR KËTË VEND QË ÇDOKUSH TË SHPREHET LIRSHËM F. 3

### HAMZA NDERON ME MIRËNJOHJE UNIONIN E BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE F. 6

### VUÇIQI: KRIJIMI I ASOCIACIONIT, PARAKUSHT PËR KTHIMIN E SERBËVE NË INSTITUCIONE F. 5

## EKONOMI



### PARALAJMËROHET SHTRENJTIMI I BUKËS, SHKAK NGRITJA E ÇMIMIT TË RRYMËS F. 8

### SUPREMJA VËRTETON QË QYTETARËVE U ËSHTË FATURUAR JASHTËLIGJSHËM RRYMA E SHPENZUAR NË KATËR KOMUNAT VERIORE F. 8

## SPORT



### FILLON EDICIONI I KATËRT I PROJEKTIT ‘ELITE YOUTH DEVELOPMENT PROGRAMME U15’ F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Norvegjia dëbon 15 "oficerë rusë të inteligjencës"

**Oslo, 13 prill** - Norvegjia ka njoftuar se do të dëbojë 15 zyrtarë të Ambasadës Ruse që, sipas Ministrisë së Jashtme, janë zyrtarë të inteligjencës që po operonin duke u paraqitur si diplomatë. Moska tha se do të kundërpërgjigjet për këtë veprim të Oslos. Me dëbimin e këtyre zyrtarëve, Oslo deri më tani ka dëbuar një të katërtën e diplomatëve rusë në Norvegji.

Vendimi i Oslos është i fundit në shtetet perëndimore që janë dëbuar diplomatë rusë që kur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës vitin e kaluar. Vetëm gjatë këtij viti, Estonia, Holanda dhe Austria, po ashtu, kanë dëbuar diplomatë rusë.

Në prill të vitit 2022 Norvegjia kishte dëbuar tre diplomatë rusë. "Ky është një hap i rëndësishëm në luftimin dhe uljen e nivelit të aktivitetit të inteligjencës ruse në Norvegji dhe në këtë mënyrë për t'i mbrojtur interesat tona kombëtare", tha përmes një deklarate ministrja e Jashtme norvegjeze, Anniken Huitfeldt. "Rusia aktualisht paraqet kërcënimin më të madh të inteligjencës për Norvegjinë. Ne nuk do të lejojmë që oficerët e inteligjencës ruse të operojnë duke u paraqitur si diplomatë", shtoi ajo.

Sipas autoriteteve norvegjeze, zyrtarët rusë duhet ta lëshojnë territorin e Norvegjisë shumë shpejt.

Ministria e Jashtme ruse tha se Moska do të përgjigjet për dëbimin e zyrtarëve të saj, raportoi agjencia shtetërore e lajmeve, TASS, pa dhënë më shumë detaje.

Norvegjia, shtet i aleancës ushtarake të NATO-s, ndan kufi me Rusinë në Arktik.

Dëbimet mund të ndërlikojnë edhe më tej procesin e transferimit të kryesimit të Këshillit të Arktikut, që është një trup shumëpalësh ku shtetet e Arktikut bisedojnë për çështjet që prekin rajonin polar.

Moska aktualisht udhëheq këtë këshill, por Norvegjia pritet ta marrë kryesimin e këshillit më 11 maj.



# Rritet numri i ekzekutimeve në Iran

**Tehrani, 13 prill** - Irani ka varur 75 për qind më shumë njerëz më 2022 sesa vitet paraprake, thanë dy organizata për të drejtat e njeriut, duke dënuar "makinerinë e ekzekutimeve" që synon të përhapë frikë në shtetin që është mbërthyer nga protestat. Sipas organizatave, të paktën 582 ekzekutime janë kryer vitin e kaluar, që është shifra më e lartë e regjistruar që nga viti 2015. Më 2021 ky shtet kishte ekzekutuar 333 persona, thanë organizatat Iran Human Rights (IHR) me seli në Norvegji dhe Together Against the Death Penalty (ECPM) me seli në Francë.



Viti i kaluar u përshkrua me shpërthimin e protestave mbarëkombëtare, pasi Mahsa Amini, 22 vjeçe, vdiq në shtator teksa po mbahej në paraburgim nën dyshimet se kishte shkelur rregullat e veshjes së shamisë së kokës.

Autoritetet u përgjigjën duke shtypur protestat dhe duke dënuar me varje katër persona për shkak të protestave, duke nxitur pakënaqësi në komunitetin ndërkombëtar.

Mahmood Amiry Moghaddam, drejtor i IHR, tha se përderisa reagimi ndërkombëtar ishte për t'i mbajtur nën vëzhgim ekzekutimet për shkak të protestave, Irani vazhdoi ekzekutimet për çështje të tjera penale, duke frikësuar popullatën. "Reagimet ndërkombëtare për dënimet me vdekje të protestuesve e kanë bërë të vështirë për Republikën Islamike t'i vazhdojë ekzekutimet", tha ai. "Për të kompensuar këtë dhe me qëllim që të nxisin frikë në mesin e popullatës, autoritetet kanë shtuar ekzekutimet për veprat penale që nuk janë të lidhura me çështje politike", shtoi ai.

Në raport u tha se pasi katër burra u ekzekutuan për vepra penale të lidhura me protestat, edhe 100 protestues të tjerë ende rrezikojnë të ekzekutohen pasi janë dënuar me vdekje apo përballen me akuza, për të cilat parashihet dënimi me vdekje. Në raportin e dy organizatave u tha se ka rritje të madhe të ekzekutimeve që lidhen me akuzat për drogë.

Sipas të dhënave të dy organizatave, mbi gjysma e ekzekutimeve janë kryer pas nisjes së protestave dhe 44 për qind e ekzekutimeve të regjistruara më 2022 ishin të lidhura me akuza të lidhura me drogë.

Në raportin e dy grupeve për të drejtat e njeriut thuhet se 30 për qind e të ekzekutuarve ishin myslimanë sunitë të minoritetit baluç. "Dënimi me vdekje është pjesë e diskriminimit sistematik dhe shtypjes së madhe që përballen minoritetet etnike në Iran", u tha në raport.

# Dokumentet e Pentagonit zbulojnë mospajtimet mes forcave ruse për numrin e të vdekurve

**Uashington, 13 prill** - Dokumentet e Pentagonit zbulojnë mospajtimet mes forcave ruse për numrin e të vdekurve

Dokumentet e rrjedhura nga Pentagoni kanë zbuluar se disa mosmarrëveshje brenda forcave ruse bënë që Ministria ruse e Mbrojtjes të akuzohet se nuk po e raporton numrin e saktë të viktimave të luftës në Ukrainë, duke publikuar numra më të ulët.

Rusia nuk ka zbuluar shumë të dhëna lidhur me numrin e të vdekurve shkaku i luftës në Ukrainë. Por, dokumentet e publikuara së fundi tregojnë se shërbimi i sigurisë FSB pretendonte se zyrtarët nuk po i numëronin vdekjet e anëtarëve të Gardës Kombëtare Ruse, mercenarëve të Wagnerit dhe disa forcave të tjera.

Rusia ka pretenduar se të dhënat e zbuluara nga këto dokumente mund të jenë të rreme dhe të publikuara qëllimisht nga ShBA-ja.

Megjithatë, detajet përkojnë me atë që tashmë supozohej: se grupet ushtarake dhe ato të sigurisë ruse kanë pasur mosmarrëveshje të shpeshta në lidhje me mënyrën sesi po trajtohet lufta në Ukrainë dhe se Rusia ka evituar publikimin e numrit të të vdekurve dhe të plagosurve.



Shifra e raportuar për gati 110 mijë viktima deri në muajin shkurt të këtij viti - sipas një llogaritjeje të raportuar të FSB-së - është shumë më e ulët se shifrat e zbuluara në dokumentet amerikane, që vlerësojnë se forcat ruse kanë pësuar nga 189 500 deri në 223 000 viktima, me rreth 35 5000 deri në 43 000 të vrarë në fushëbetejë. Shifra më e fundit zyrtare e Rusisë daton në shtator të vitit të kaluar, kur u konfirmuan vdekjet e 5 937 ushtarakëve.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Presidenti i Shqipërisë bën thirrje për zgjedhje të lira dhe pa keqpërdorime



Tiranë, 13 prill - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, bëri thirrje për një fushatë zgjedhore të qetë dhe larg fenomeneve negative që u vërejtën në zgjedhjet e kaluara, pas një takimi me përfaqësues të institucioneve dhe organizata që do të organizojnë dhe monitorojnë procesin zgjedhor.

Ky takim, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Ambasadës së ShBA-së, Zyrës së BE-së dhe kryesuesja e misionit të OSBE/ODIHR, Audrey Glover, u zhvillua një ditë para hapjes së fushatës për zgjedhjet lokale që do të zhvillohen në Shqipëri më 14 maj. "Partitë politike duhet të paraqesin vetëm ofertë. Përvojat e mëparshme na kanë përballur jo rrallëherë me fenomene negative dhe me forma të paligjshme si pjesë e fushatës zgjedhore dhe institucionet jo gjithmonë kanë reaguar me sukses", tha Begaj.

Ai shtoi se "fenomenet e shitblerjes së votës, keqpërdorimit të burimeve financiare, financimet jotransparente dhe prishja e procesit zgjedhor janë të patolerueshme". "Policia duhet të reagojë përballë çdo fenomeni që mund ta cenojë procesin zgjedhor. Monitoruesit dhe komisionarët duhet të punojnë paanshmërisht", tha ai.

Presidenti Begaj kërkoi nga përfaqësuesit e partive politike që të mos përdorin gjuhë denigruese ndaj njëri-tjetrit gjatë fushatës zgjedhore dhe të paraqesin ide dhe programe që përmirësojnë realisht jetën e qytetarëve.

Kreu i shtetit shqiptar bëri një thirrje edhe për qytetarët me të drejtë vote, duke iu kërkuar atyre ta shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe të denoncojnë çdo rast shantazhimi apo intimidimi.

Dy ditë më parë, i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, vizitoi Tiranën dhe u takua me krerët institucionalë. Ai takoi presidentin Begaj, kryeministrin Edi Rama dhe ministren e Jashtme, Olta Xhaçka, ndërsa zhvilloi takime edhe me përfaqësuesit e opozitës, Enkelejd Alibeaj dhe Ilir Metën.

Ambasada Amerikane në Shqipëri tha se thirrja e Escobarit për liderët ka qenë që "të sigurojnë që kandidatët t'i përmbushin kërkesat e ligjit dhe t'i përmbushin pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë për integritet të lartë".

Thirrje të ngjashme ka bërë edhe ambasadorja amerikane në Tiranë, Yuri Kim, ditë më parë. Por, pavarësisht prej këtyre thirrjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që ka verifikuar kandidatët për 61 bashkitë dhe kandidatët për këshillat bashkiakë, ka gjetur se për 34 kandidatë ka dyshime për "pastërtinë e figurës". Nga 34 kandidatët, dhjetë janë për kryetar bashkie dhe gjysma e tyre i përkasin Partisë Socialiste.

Kryekomisionari Ilirjan Celibashi tha se për këta kandidatë ka dyshime se mund ta kenë shkelur formularin e dekriminalizimit dhe për këtë arsye do të verifikohen nga Prokuroria.

Partia Socialiste dhe koalicioni "Bashkë Fitojmë", në të cilin bëjnë pjesë "Partia e Lirisë" e Ilir Metës dhe një grup deputetësh demokratë - që udhëhiqen nga Sali Berisha - garojnë me kandidatë në 61 bashkitë e vendit.

Partia Demokratike ka dalë me kandidatë në vetëm 15 bashki, pasi nuk është arritur kompromis që dy grupet brenda Partisë Demokratike të dalin me kandidatë të përbashkët.

Ndarja e thellë në PD u krijua në maj të vitit 2021, kur ShBA-ja shpalli ish-kryeministrin Berisha person të padëshiruar. Kjo rezultoi me krijimin e strukturave paralale brenda partisë më të madhe opozitare, madje edhe në protesta të dhunshme.

Kandidatët e propozuar dhe të mbështetur nga Sali Berisha nuk do të garojnë nën logon e PD-së, por të koalicionit "Bashkë Fitojmë", që drejtohet nga partia e së majtës e Ilir Metës - Partia e Lirisë. Aktualisht thuajse të gjitha bashkitë e vendit drejtohen nga Partia Socialiste për shkak se opozita i pati bojkotuar zgjedhjet lokale të vitit 2019.

# Mavraj dënon sulmin ndaj Sylës: E kemi çliruar këtë vend që çdokush të shprehet lirshëm



Prishtinë, 13 prill (ER) - Publicisti Muhamet Mavraj ka dënuar sulmin fizik ndaj gazetarit Valon Syla. Ai ka thënë se ndien neveri nga ky akt i shëmtuar.

Mavraj ka thënë se ky vend është çliruar me mund vetëm që çdokush të shprehet dhe të mendojë lirshëm. "E kemi çliruar këtë vend me mijëra sakrifica, që çdokush të jetojë i lirë, të besojë çfarë të dojë, të shprehet lirshëm dhe lirshëm të mendojë. Dalin mijëra pishpirika pas luftës për ta treguar trimërinë që u mungonte dje, atyre dhe baballarëve të tyre. I kemi falë në luftë spiunët e hajdutët, dalin këta sot e na quajnë tradhtarë e të shitur", ka shkruar Mavraj në "Facebook".

Ai ka thënë se mbështet çdo opinion të gazetarit Syla, pavarësisht nëse pajtohet ose jo me të. "Mbështes pa rezervë çdo opinion të lirë të Valonit, fuqishëm, pavarësisht a pajtohem a nuk pajtohem. Atmosferën dhe kulturën e linçimit e njohim moti këtu, me dekada, por kultivuesit e tyre kanë mbaruar në kosh mbeturinash", ka shkruar Mavraj.

### Postimi i plotë i Mavrajt:

E kemi çliruar këtë vend me mijëra sakrifica, që çdokush të jetojë i lirë, të besojë çfarë të dojë, të shprehet lirshëm dhe lirshëm të mendojë. Dalin mijëra pishpirika pas luftës për ta treguar trimërinë që u mungonte dje, atyre dhe baballarëve të tyre. I kemi falë në luftë spiunët e hajdutët, dalin këta sot e na quajnë tradhtarë e të shitur. Dhe, ua han mendja të përdorin dhunë për sa kohë që i tolerojmë me të butë.

Me neveri e dënoj sulmin fizik ndaj kolegut VALON SYLA, nga tre pishpirika. Porositësi i dhunës duhet ta dijë se dhuna sjell dhunën e në sytë e mi ishte dhe mbetet një lepur prapa xhamave të errët, nuk bëhet dot luan.

Mbështes pa rezervë çdo opinion të lirë të Valonit, fuqishëm, pavarësisht a pajtohem a nuk pajtohem. Atmosferën dhe kulturën e linçimit e njohim moti këtu, me dekada, por kultivuesit e tyre kanë mbaruar në kosh mbeturinash.

Me vjen keq që Kosovës po i del ky nam i zi nga abuzuesit e lirisë. Dimë të themi Mjaft është Mjaft, një ditë.



# Kërkohet shtyrja e zgjedhjeve në veri

Edhe dhjetë ditë kanë mbetur deri në mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës, por ka shumë dilema nëse këto zgjedhje do të mbahen më 23 prill. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk ka miratuar listën e qendrave të votimit. Njohës të proceseve zgjedhore dhe përfaqësues nga opozita e kanë vlerësuar të vështirë organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike në veri të Kosovës nëse merret parasysh situata politike. Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se këto zgjedhje duhet të shtyhen

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 PRILL - Edhe dhjetë ditë kanë mbetur deri në mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk ka miratuar listën e qendrave të votimit. Deri më tani është votuar në shkolla, por këtë herë shanset për këtë janë pothuajse joekzistente sepse ato kontrollohen nga sistemi serb në veri, i cili i kundërshton zgjedhjet. Qendrat alternative si dhe stacionet policore, po ashtu, janë përmendur si vende të mundshme që mund të shndërrohen në qendra të votimit. Moscaktimi i qendrave të votimit krijon dyshime se aktiviteti zgjedhor mund të zhvillohet, thonë ish-kryeshefi ekzekutiv i KQZ-së, Adnan Merovci, dhe përfaqësuesi i organizatës joqeveritare Demokracia në Veprim (DnV), Eugen Cakolli.

Adnan Merovci e vlerëson të vështirë organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike në veri të Kosovës nëse merret parasysh situata politike.

Gjendja politike në atë pjesë të shtetit është e brishtë dhe kjo, sipas tij, ka pamundësuar që institucionet përgjegjëse t'i përfundojnë me kohë procedurat teknike për organizimin e zgjedhjeve. "Nëse gjendja në veri është e tillë, që ende vendvotimet nuk janë caktuar, ende aspekti teknik nuk është marrë në duart e atyre që quhen komisionarë, udhëheqës të vendvotimeve, unë jam skeptik...", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Eugen Cakollit nga Demokracia në Veprim thotë se për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve KQZ-ja shumë shpejt duhet ta publikojë lokacionin e qendrave të votimit në mënyrë që të informohen votuesit se ku mund të votojnë.

Ky proces, sipas tij, është dashur të përfundojë 45 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve. "Më e rëndësishme është publikimi i qendrave të votimit. Ende nuk dihet se cilat do të përdoren për qëllim të zhvillimit të procesit të votimit. Janë përmendur modalitete të shumta, si qendra alternative apo votim në stacione policore e të tjera", thotë ai.

Ndërkaq kryetari i subjektit opozitar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të marrin vendim që t'i shtyjnë zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës.

Gjatë një fjalimi në Kuvendin e Kosovës të enjten, Haradinaj ka thënë se gjendja në veri të Kosovës nuk garanton që zgjedhjet e parapara për 23 prill të sjellin sukses. "Unë u bëj thirrje qeverisë, presidentes, institucioneve të vendit që ta marrin me seriozitet gjendjen në veri dhe ta marrin një vendim për këtë situatë. Cili do të duhej të ishte ai vendim, unë besoj shumë [se do të duhej të ishte] shtyrja e zgjedhjeve", ka thënë Haradinaj.

Më 23 prill pritet të mbahen zgjedhje të jashtëzakonshme për kryetar të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit si dhe zgjedhje të parakohshme për dy kuvendet komunale, në Zveçan dhe Leposaviq.

Vendimi për zgjedhjet është marrë pasi kryetarët e këtyre komunave, bashkë me serbë të tjerë, më 5 nëntor të vitit të kaluar dhanë dorëheqje, në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. "E dini se zgjedhjet e shpallura herën e parë nuk arritëm t'i mbajmë. Dhe, po ashtu, e dini se procesi për të mbajtur zgjedhje tash në veri nuk është i qëndrueshëm", tha Haradinaj, duke iu referuar shtyrjes së zgjedhjeve në veri, që paraprakisht ishin paraparë të mbaheshin në dhjetorin e kaluar.

Haradinaj tha se është më mirë që Kosova të pranojë "çerek humbje sot, një gjysmë humbje nesër" sesa një "humbje të plotë në ditën e zgjedhjeve".

Lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në veri, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ende nuk ka marrë vendim për listën e qendrave të votimit.

Deri më tani për zgjedhjet lokale dhe parlamentare në Kosovë institucionet arsimore zakonisht janë shfrytëzuar si qendra votimi, por kjo praktikë mund të ndryshojë për faktin se shkollat në mjediset serbe në Kosovë punojnë sipas sistemit të Serbisë dhe drejtorët mund të mos lejojnë shfrytëzimin e shkollave për votime.

Një prej opsioneve që është përmendur është që votimi të zhvillohet në stacione policore dhe Haradinaj u shpreh kundër diçkaje të tillë. Ai tha se mbajtja e zgjedhjeve në një situatë të tillë do të mund t'i "thellonte pasojat" për Kosovën.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) vlerëson se në këto rrethana nuk ka kushte për mbajtje të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, sipas ligjit dhe sipas standardeve minimale ndërkombëtare prandaj, sipas këtij institucioni, duhet të mendohet nëse ia vlen të bëhet një improvizim i mbajtjes së zgjedhjeve në këto kushte e që, pa asnjë dyshim, do të përsëriteshin shpejt. "Mundësia e vetme e mbajtjes së zgjedhjeve është harmonizimi i një marrëveshje politike, në nivelin më të lartë, ndonëse zgjedhjet janë çështje ekskluzivisht e brendshme e një shteti. Mirëpo ky standard dhe parim, me rastin e Kosovës, është shkelur shumë herë. Është kohë shumë e shkurtër të pranohen kushtëzimet politike të Listës Serbe siç janë formimi i menjëhershëm i Asociacionit - Zajednicës dhe tërheqja e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës por… nuk i dihet! Në këto rrethana nuk ka as kushte minimale për mbajtje të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës. Në anën tjetër, veriu i Kosovës, për shkak të bojkotit, është shndërruar në shkretëtirë të

# Vuçiqi: Krijimi i Asociacionit, parakusht për kthimin e serbëve në institucione

PRISHTINË, 13 PRILL - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas takimit në Rashkë me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, tha se parakusht për kthimin e serbëve në institucionet e Kosovës është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Duke paraqitur pesë konkluzat e takimit, Vuçiqi tha se Asociacioni duhet të formohet "ekskluzivisht në përputhje me marrëveshjet e arritura në Bruksel".
Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin, më 2013 dhe 2015. Marrëveshja e fundit Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka thënë se nuk është në harmoni të plotë me aktin më të lartë juridik të shtetit, por mund të harmonizohet me akte ligjore.
Vuçiqi tha se Asociacioni është parakusht edhe për hapat e mëtejshëm në dialog si dhe parakusht për kthimin e serbëve në institucione. Sipas konkluzave të lexuara në fund të takimit me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, do të kërkohet reagimi urgjent i Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tjera në botë që institucionet në Prishtinë "ta ndërpresin menjëherë shkeljen e marrëveshjes për targat dhe të mundësojnë lëvizjen e papenguar të serbëve, automjetet e të cilëve shfrytëzojnë targa legjitime të Republikës së Serbisë". "Nuk kërkojmë asgjë më shumë se Prishtina, pa vonesë, të veprojë në përputhje me marrëveshjet në dialog, si dhe me të gjitha dokumentet e tjera relevante të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kuptim, ekipi negociator serb autorizohet që në përputhje me të drejtat që i janë garantuar palës serbe në marrëveshjet e deritashme për targat, të bëjë përpjekje shtesë për gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi për këtë çështje", ka theksuar Vuçiqi.
Më 2022 në veriun e Kosovës u rritën tensionet për shkak të një vendimi të qeverisë në Prishtinë që të gjitha veturat me targa ilegale serbe të riregjistroheshin në targa Republika e Kosovës - RKS. Tensionet u ulën pasi palët arritën një marrëveshje në Bruksel përmes së cilës Prishtina hoqi dorë nga masat ndëshkuese që derivonin nga vendimi për targat, ndërkaq Beogradi hoqi dorë nga lëshimi i targave të reja për makinat që qarkullojnë në veri të Kosovës.
Një prej konkluzioneve të arritura në Rashkë kërkon edhe tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu, i banuar me shumicë serbe. Në konkluza thuhet se Serbia nuk ka marrë pjesë në vendimin për të mos marrë pjesë në zgjedhjet e 23 prillit në Kosovë, por se nuk dëshiron të dalë kundër këtij vendimi.
Shtohet se do të kërkohet që zgjedhjet të zhvillohen pas formimit të Asociacionit.
Pika e fundit e konkluzave është se Serbia do t'i marrë të gjitha "masat juridike, politike dhe ekonomike" për ta siguruar mbrojtjen dhe të drejtat e serbëve në Kosovë. Këto konkluza, sipas Vuçiqit, do të miratohen nga qeveria serbe dhe institucionet do të jenë të obliguara t'i respektojnë.



veprimit institucional", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.
Edhe "Demokracia në Veprim" para disa ditësh ka vlerësuar se rrethanat aktuale nuk mundësojnë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve. Sipas DnV-së, për shkak të dorëheqjeve të zyrtarëve zgjedhorë të komunitetit serb nga trupat menaxhuese zgjedhore, si dhe mungesës së interesimit të tyre për të aplikuar, KQZ-ja po përballet me sfida në zhvillimin e përgatitjeve të nevojshme për të organizuar dhe administruar një proces të rregullt dhe të mirëfilltë zgjedhor. DnV-ja ka shtuar se paqartësitë lidhur me shfrytëzimin e qendrave ekzistuese të votimit, emërimin dhe trajnimin me kohë të komisionarëve, bartjen e materialeve zgjedhore janë disa nga problemet kyçe me të cilat pritet të ballafaqohen trupat menaxhuese të zgjedhjeve. "Në përgjithësi, situata e sigurisë në katër komunat veriore vijon të jetë e brishtë. Dorëheqjet e zyrtarëve policorë serbë në ato komuna përbëjnë handikap të madh në garantimin e sigurisë, veçanërisht gjatë procesit zgjedhor", thuhet në reagimin e DnV-së, duke rikujtuar që krijimi i një ambienti të sigurt është parakusht thelbësor për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. "Në anën tjetër, si rezultat i këtyre faktorëve, mund të pritet një mungesë e theksuar e interesimit të qytetarëve të komunitetit serb për të marrë pjesë në zgjedhje. Kjo pritet të manifestohet edhe me dalje shumë të ulët në zgjedhje, që do ta cenojë legjitimitetin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 23 prillit. Andaj, marrë parasysh situatën e tanishme në terren, DnV vlerëson që rrethanat e tanishme nuk mundësojnë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në veri në përputhje me standardet për zgjedhje të lira dhe të drejta", është theksuar në reagimin e DnV-së.
Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka deklaruar se ka tendencë të qartë që të destabilizohet veriu i Kosovës përpara zgjedhjeve të 23 prillit. Ai për "KosovaPress" ka theksuar se shtyrja e dytë e këtyre zgjedhjeve është e paarsyeshme. Sipas tij, institucionet duhet t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre ligjore e kushtetuese. "Meqenëse zgjedhjet po afrohen tash, pra pas dhjetë dite është data e zgjedhjeve, nuk janë të rastësishme të gjitha këto që po ndodhin, meqë është një tendencë e qartë që të destabilizohet ajo pjesë e vendit përpara zgjedhjeve të 23 prillit. Me qëllim që të delegjitimohet i gjithë procesi, që edhe në anën tjetër të krijohet përshtypja e rrejshme, por me mjete të dhunshme që pa Listën Serbe edhe pa këto struktura nuk ka qetësi dhe paqe në pjesën e veriut të Kosovës", ka deklaruar Konjufca.
Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit, ka refuzuar të marrë pjesë në zgjedhje. Në zgjedhjet e 23 prillit për kryetar të komunave do të garojnë 11 kandidatë nga katër subjekte politike, prej të cilëve vetëm dy janë të komunitetit serb.




# Hamza nderon me mirënjohje Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane

Mitrovicë, 13 prill - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim përfaqësues nga Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në krye me kryetarin Nazmi Viqa. Në këtë takim kryetari Hamza i ndau mirënjohje Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në shenjë falënderimi për vullnetin dhe kontributin e dhënë gjatë përballjes me vërshimet në komunën e Mitrovicës. Me këtë rast, përfaqësuesit e kësaj organizate, pasi kanë falënderuar kryetarin Bedri Hamza për mikpritjen e ofruar, janë shprehur të gatshëm për të bashkëpunuar në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve.

# Fillon ndërtimi i një shkolle të re në Prishtinë

Prishtinë, 13 prill - Kanë filluar punimet për ndërtimin e shkollës së re të mesme "7 shtatori". "Bashkë me drejtorin e Investimeve Kapitale, Krenar Xhaferi, dhe drejtoreshën Besianë Musmurati, kemi nisur këtë projekt me shumë zell dhe entuziazëm. Jemi të lumtur që po bëjmë hapin e parë drejt realizimit të kësaj shkolle dhe presim me padurim ndikimin pozitiv që kjo shkollë do të ketë në nxënësit dhe komunitetin tonë. Dëshirojmë t'i falënderojmë të gjithë anëtarët e ekipit që kanë ndihmuar në fillimin e këtij procesi", ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



# Totaj nënshkruan marrëveshjen për inkurajimin e të rinjve për zhvillimin e tyre profesional




**Prizren, 13 prill** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Gjermane Help dhe Makerspace Innovation Center Prizren në kuadër të projektit "Programi i trajnimit për punësim - shkathtësi digjitale".
Totaj ka bërë me dije se synimi i këtij projekti është t'u ofrojë ndihmë të rinjve të papunësuar dhe të papërcaktuar profesionalisht që ta orientojnë zhvillimin e tyre profesional drejt përvetësimit të shkathtësive digjitale inovative dhe t'u ofrojë mundësi punësimi përfituesve.
"Përkrahja do t'u ofrohet të rinjve të regjionit të Prizrenit pa dallim, përmes ndërtimit të aftësive personale dhe profesionale si dhe fuqizimit të tyre ekonomik. Në kuadër të projektit do të mbështeten gjashtëdhjetë të rinj në synimet e tyre për të filluar karrierë në fushat e shkathtësive digjitale", ka theksuar Totaj.
Komuna e Prizrenit, organizata Help dhe Makerspace Innovation Center Prizren, përmes kësaj mbështetjeje, ka për qëllim inkurajimin e të rinjve për zhvillimin e tyre profesional dhe për pavarësi financiare.

# Përkujtohen dëshmorët Dalip Behra e Bekim Gashi, Latifi: Ishin shembull i sakrificës dhe guximit

**Rahovec, 13 prill** - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në shënimin e 24-vjetorit të rënies në fushëbetejë te "Rrezet e Krushës" të dëshmorëve Dalip Behra dhe Bekim Gashi. Latifi ka thënë se sot po nderojnë kujtimin për jetën, veprën dhe sakrificën e tyre për liri. "Dëshmorët Dalip Behra e Bekim Gashi janë shembull i sakrificës, i guximit, i nderit dhe i nderimit të atdheut dhe kombit! Këta trima i vunë gjoksin furtunës dhe vendosën të përballen me fatin, duke besuar thellë, se e drejta është në anën tonë dhe këtë luftë duhet ta fitojmë ne: të nëpërkëmburit, të dhunuarit, të persekutuarit, të gjymtuarit e të shndërruarit në hiç", ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se rruga e luftës mbeti e vetmja mundësi për dinjitet njerëzor e kombëtar e për t'ia sjellë lirinë kësaj toke që po rënkonte nga dhimbjet e çizmes së huaj. "I përjetshëm kujtimi për Dalipin, Bekimin dhe të gjithë të rënët për lirinë e Kosovës!", ka thënë kryetari Latifi.



## Nis ndërtimi i sistemit të trajtimit të ujërave të zeza në Polac të Skenderajt

**Skenderaj, 13 prill** - Në fshatin Polac të Skenderajt ka filluar realizimi i projektit të ri për ndërtimin e sistemit të trajtimit të ujërave të zeza nga lagjja Aliuka, pastaj do të vazhdojë trajtimi edhe në lagjet e tjera të fshatit. Për të parë nga afër fillimin e punimeve ka dalë kryetari i komunës, Fadil Nura, i cili shoqërohej nga drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, Driton Mulaj dhe asamblistja Liridona Koci. Projekti në fjalë parasheh ndërtimin e sistemit të kanalizimit për lagjet e fshatit Polac, një nga premtimet e qeverisjes Nura për përmbushje të kërkesave të banorëve të Polacit.



# Fillon procesi për rishikimin e teksteve dhe materialeve mësimore për klasat I-IX

Rishikimi i teksteve shkollore për përmirësimin e cilësisë së tyre do të fillojë me tekstet e lëndëve të Gjuhës Shqipe dhe Matematikës të klasave I-IX, për të vazhduar me lëndët dhe fushat e tjera kurrikulare

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 PRILL - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit ka paraqitur fillimin e procesit të rishikimit të teksteve dhe materialeve mësimore për klasat I-IX. Procesi i rishikimit të teksteve shkollore do të udhëhiqet nga Ministria e Arsimit dhe do të mbështetet nga projekti KosEd, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Ministrja Arbërie Nagavci ka thënë se në këtë fazë rishikimi i teksteve shkollore për përmirësimin e cilësisë së tyre do të fillojë me tekstet e lëndëve të Gjuhës Shqipe dhe Matematikës të klasave I-IX, për të vazhduar me lëndët dhe fushat e tjera kurrikulare.

Ministrja Nagavci ka theksuar se ky proces do të ketë efekt të menjëhershëm në punën e përditshme në shkolla, rrjedhimisht edhe në rezultatet e të nxënit, duke qenë se teksti është një nga burimet kryesore të informatës në vendin tonë.

Duke folur për sfidat dhe problemet në lidhje me tekstet shkollore ndër vite, ministrja Nagavci tha se cilësia e teksteve shkollore në një vend ka kapacitetin që të ndikojë, në plan afatgjatë, në cilësinë e jetës dhe zhvillimit në atë vend.

Ndër të tjera, Nagavci ka theksuar se mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, mediet dhe aktorë të tjerë kanë adresuar ankesa të shumta lidhur me cilësinë e teksteve shkollore, të cilat edhe do të shërbejnë si pikënisje e punës për rregullimin e lëshimeve të bëra.

Drejtori i Institutit EdGuard, Rinor Qehaja, ka thënë se Ministria e Arsimit ka bërë një hap të madh për fillimin e një procesi kaq të rëndësishëm dhe për finalizimin e Ligjit për Tekste Shkollore, ndërsa ka bërë me dije se metodologjia e procesit të rishikimit është ndërtuar mbi gjendjen e vërtetë të cilësisë dhe teksteve dhe ofrimin e rekomandimeve të cilat do ta nxisin përmirësimin e tyre.




# Gruda: Qeveria Kurti po e mban kundërligjshëm në detyrë kryeinspektorin e Punës

Prishtinë, 13 prill (ER) - Koordinatori i Departamentit për Drejtësi në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Përparim Gruda, në një konferencë për medie, ka zbuluar se emërimi i kryeinspektorit të Punës, Hekuran Nikçi, është bërë në mënyrë të kundërligjshme.

Gruda ka thënë se kemi të bëjmë me një shkelje flagrante dhe të hapur të ligjit dhe vendimeve të gjykatave të Kosovës nga ana e qeverisë Kurti.




"Vitin e kaluar, me propozim të Ministrisë së Financave, Qeveria e Kosovës ka emëruar kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi. Ky emërim është bërë në kundërshtim me ligjin në fuqi për zyrtarët publikë, pasi për këtë pozitë nuk ka pasur fare konkurs publik", ka thënë Gruda.

Se kryeinspektori i Inspektoratit të Punës është emëruar në mënyrë të paligjshme kishte konstatuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShC) përmes raportit të Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave. Përkundër këtij vendimi të Këshillit, qeveria ka vazhduar të mos e largojë nga detyra kryeinspektorin Nikçi, duke iu drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë. Edhe në Gjykatën Themelore qeveria e ka humbur rastin, pasi gjykata ka refuzuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të KPMShC-së.

Duke mos u bindur, ata janë ankuar në Gjykatën e Apelit, por edhe kjo gjykatë e ka refuzuar të pabazuar ankesën e tyre duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. "Imagjinojeni, një person është emëruar dhe mbahet në detyrë në mënyrë të paligjshme në një organ që supozohet t'i mbrojë të drejtat e punëtorëve. Askund nuk ka ndodhur që qeveria e një vendi ta bëjë zakon shkeljen e Kushtetutës, ligjeve dhe vendimeve gjyqësore të vendit, siç po e bën qeveria Kurti. Partia Demokratike e denoncon këtë si një rast të paprecedent të shkeljes së qëllimshme të ligjit dhe vendimeve të gjykatave dhe e fton prokurorinë e shtetit t'i marrë të gjitha veprimet e nevojshme ndaj personave që nuk i kanë zbatuar vendimet e gjykatave", ka përfunduar koordinatori për drejtësi në KQM, Përparim Gruda.

## FSK-ja realizon ushtrimin fushor "Steel Live Alpha"

Gjakovë, 13 prill - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka realizuar ushtrimin fushor "Steel Live Alpha" në Aeroportin e Gjakovës dhe Babaj të Bokës. "Me qëllim që pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) të jenë sa më të trajnuar në aspektin taktik, Kompanisë 2A e Regjimentit të dytë të Komandës së Forcave Tokësore ka realizuar ushtrimin fushor 'Steel Live Alpha' në Aeroportin e Gjakovës dhe Babaj të Bokës duke praktikuar qitjen me municion real luftarak në nivel skuadre dhe togu", ka njoftuar FSK-ja.



# Paralajmërohet shtrenjtimi i bukës, shkak ngritja e çmimit të rrymës



PRISHTINË, 13 PRILL - Çmimi për një ton miell ka rënë për 30 për qind nga 550 euro sa ishte tonelata. Tani është 420 euro. Megjithatë, rënie nuk ka pësuar edhe çmimi i bukës. Buka aktualisht në furrat e Kosovës kushton 0.50 euro e në disa furra edhe 0.60 euro, por ky çmim nuk do të jetë për shumë kohë, pasi që çmimi i saj pritet të ngrehet së shpejti edhe më shumë.
Shtrenjtimi i bukës pritet të ndodhë pas vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), e cila rriti çmimin e energjisë elektrike në masë prej 15.4-përqindësh nga 1 prilli.
Për rritjen e tarifave të rrymës, kryetari i Shoqatës së Mullisëve, Bashkim Zejnullahu, ka theksuar se do të ketë një ndikim negativ te furrtarët ngaqë, sipas tij, kjo ndikon në koston e përpunimit dhe sjell efekte negative.
Ndërsa Zjenullahu shton se pas zbritjes së çmimit të miellit, duhet të reflektojnë edhe në rënien e çmimit të bukës. "Produktet e grurit kanë pësuar rënie kohën e fundit, e cila ka reflektuar edhe në çmimin e miellit - çmimi aktual nga 420 euro deri 460 euro për tonelatë, ndërsa vendi ynë ka një qëndrueshmëri të sasive të grurit. Nuk mendoj se do të rritet, përkundrazi presim një rënie të çmimit të bukës duke pasur parasysh çmimin e miellit i cili ka pësuar rënie prej 30-përqindësh. Ky çmim duhet të reflektojë edhe në rënie të çmimit të bukës", është përgjigjur Zejnullahu.
E vendimin për rritje të çmimit të bukës nuk e mirëpresin as qytetarët. Ata thanë se në krizën financiare në të cilën janë nuk duhet të ndodhë një rritje e tillë.
Qytetari Vesel Veseli thotë se një vendim i tillë për rritje të çmimit të bukës është i papërshtatshëm, marrë parasysh buxhetin e familjeve, gjersa shton se qeveria duhet të marrë masa parandaluese për një rritje të tillë. "Ky është vendim i papërshtatshëm për shumicën e popullatës sonë, duke marrë parasysh se çfarë buxheti familjar kanë, andaj qeveria duhet të marrë masa që t'i shtojë ndihmat sociale, pensionet, pagat e punëtorëve që janë duke punuar, shërbyesve civilë dhe jo vetëm të ngrehen çmimet e artikujve ushqimorë dhe pagat të mos rriten, nuk është e arsyeshme. Furrtarëve po iu kushton rryma, që i pjekun ato (bukët) dhe ndikon që ata ta ngrehin çmimin. Po sikur mos të kishte qenë rryma me çmim të lartë dhe krahas miellit, do ta kishin bërë edhe çmimin e bukës. Mua nuk më pengon, sepse kam të hyra financiare, mirëpo bazohen në shumicën e popullatës, se në çfarë gjendje janë", u shpreh ai.
Ilmi Beqiri thotë se kjo rritje e çmimit është interes i furrtarëve, gjersa shton se një ngritje e çmimit të bukës është e papërballueshme. "Nuk mund ta përballojmë jo vetëm ne, por askush. Po flitet se do të rritet çmimi i bukës dhe i gjërave ushqimore. Nuk e di si do ta përballojë populli. Këta janë duke luajtur me popull. Sigurisht kanë diçka, interesa të tyre", tha ai.
Me pagat e dobëta rritja e çmimeve është e papërballueshme për qytetarët, tha qytetari Bislim Ademi. "Nuk është e arsyeshme. Pensionet dhe pagat, të gjitha të dobëta. Është e papërballueshme jo vetëm buka, por edhe shumë artikuj ushqimorë", ka theksuar ai.
Situata me ngritjen e çmimeve i duket normale qytetarit Hashim Thaçi. "Tash çdo gjë po më duket normale. I kanë shtrenjtuar të gjitha, edhe bukën, veç edhe shpirtin të na marrin dhe nuk ka tjetër. Shumë normale është kjo për ne, për Kosovën. Çfarë të na bën qeveria ashtu është. Këtë qeveri e kemi kërkuar, 51 për qind e kemi votuar dhe duhet të bëjmë siç thotë", u shpreh ai.
Kosova është përballur me rritje të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve nga fundi i vitit të kaluar, kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia Covid-19 dhe invazioni rus në Ukrainë. /kp/

# Supremja vërteton që qytetarëve u është faturuar jashtëligjshëm rryma e shpenzuar në katër komunat veriore

PRISHTINË, 13 PRILL - Gjykata Supreme njofton se ka refuzuar kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për faturimin e rrymës të qytetarëve për katër komunat veriore të Kosovës. Sipas njoftimit, nuk janë të qëndrueshme pretendimet lidhur me arsyetimin e mosinkasimit në katër komunat e veriut me shkaqe sigurie. "Nuk janë të qëndrueshme pretendimet lidhur me arsyetimin e mosinkasimit në katër komunat e veriut me shkaqe sigurie dhe mospasje qasje në leximin e njehsorëve në atë pjesë, sepse nuk justifikohet që qytetarët e tjerë për këto arsye të ngarkohen me pagesën e energjisë elektrike të harxhuar pa një bazë ligjore. Prandaj me këtë faturim dhe pagesë është bërë trajtim jo i barabartë i qytetarëve të Kosovës, e që bie ndesh me nenin 55, par. 4, të Kushtetutës, trajtim i pabarabartë, të cituar si në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, sepse është bërë kufizim i të drejtave të njeriut", thuhet në njoftimin Supremes. Po ashtu, aty thuhet se konsumatorët, pa dijeninë e tyre, janë faturuar dhe kanë paguar për energjinë e shpenzuar në veri. "Bazuar në nenin 194 të LMD-së, konsumatorët, të cilët pa bazë ligjore dhe pa dijeninë e tyre janë faturuar dhe kanë paguar për energjinë e shpenzuar në veri, u lindë e drejta për kthimin e shumës së paguar si kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta", theksohet në njoftimin e Supremes.



# S'ka më shtëpi kurvash



Nelson ALGREN

Na ishte njëherë një shtëpi kurvash në pjesën veriore të rrugës perëndimore dyzet e pestë e cila njihej si 'Gruaja me fat'. Sapo i afroheshe dritares së kësaj shtëpie aty do të shihje një vajzë të re që rrinte ulur në një tavolinë para saj. Kur i bije ziles dera të hapej nga brenda dhe ti e paguaje atë pesëmbëdhjetë dollarë po qe se bëje vizitën e parë. Më pastaj, ajo të pajiste ty me një kartelë të vogël ngjyrë të kuqe me mbishkrim dy shkronja LL mbi të. Kjo kartelë ta zbriste çmimin deri në trembëdhjetë dollarë.

Një grup i konsiderueshëm vajzash të reja, të ngjyrave të ndryshme, disa të bardha, të zeza, aziatike ose me ngjyrë ulliri, reklamoheshin në platetë e improvizuara brenda shtëpisë. Të gjitha ishin shumë të bukura, e sidomos ato me ngjyrë ulliri dhe nga ato orientalët ishin shumë të bukura.

Yuri ishte një vajzë e re, e formuar mirë. Nuk ishte më e vjetër se njëzet e katër vjeçe. Mbante një fytyrë të ndrojtur në sallon. Por me t'u futur në dhomë me të, ajo ishte shumë e hareshme dhe sharmante. Kurrë s'e harroj përshëndetjen e saj të ngrohtë "Tung Ne'son". I kishte të merituara ato pesëdhjetë dollarë që ia jepja aty për aty.

Kryebashkiaku i Nju-Jorkut kishte planifikuar që atë vit si platformë/manifest politik ta ndalonte prostitucionin në qytet. Ed Koch do të mbahej në mend, nga gjeneratat e reja, sikur njeriu që arriti t'i flakë nga qyteti të gjitha gratë e pavyera.

"Ne do ta konsiderojmë këtë si ora e Gjonit", kishte thënë kryebashkiaku, sepse "Gjon" ishte bërë tashmë emër rutinë i burrave që frekuentonin prostitutat. "Ne do t'i publikojmë të gjithë emrat e patronëve prostitutash shumë shpejt dhe mbështetja juaj për ta paraqitur këtë problem do të jetë shumë e rëndësishme për t'i çliruar këto gra nga shfrytëzimi që po ua bëjnë këta burra të pamoralshëm atyre".

Kryebashkiaku ishte i palëkundur në këtë apel dhe të gjithë e mirëkuptuan këtë fushatë kundër prostitucionit. Por, çfarë ndodhi më pastaj ishte se gati të gjithë Gjonët e Queensit, Manhattanit e vendeve të tjera përreth erdhën në qytet që t'i dëgjojnë emrat që po publikoheshin gjë që në një mënyrë a tjetër krijoi edhe klientelë të mirë dhe të majmë për prostitutat në ditët e fundit përpara mbylljes së madhe.

"Kjo jo vetëm se do ta pastrojë qytetin nga këta njerëz të pamoralshëm, por edhe do t'i çlirojë këto gra nga sundimi i këtyre burrave dhe në gjithë këta njëzet muaj që kalova këtu si kryebashkiak, unë mund të them me plot gojë se unë e kam përkrahjen e të gjithë banorëve të këtij qyteti. Kjo të bën për të qeshur, sepse natyrisht që njerëzit e rëndomtë të këtij qyteti do të mbështesin çdo iniciativë që është në dobi të qytetit por ama, mos më thuaj që shumë prej këtyre njerëzve të thjeshtë, banorë të këtij qyteti, nuk shkojnë në sallonet e masazheve në "Times Square!" Kush mendon që është Koch!? Një njeri që po përpiqet t'i ndalë njerëzit të kenë kënaqësi e të kënaqin jetën e tyre!? Kush do t'i ndalojë këta burra të shkojnë në sallone kurvash? Ajatollahu nga Irani? Çka ky politikan s'e ka kuptuar hiç fare është se shumica e këtyre banorëve të qytetit, burrave pra, seksi përbën pjesën më të rëndësishme dhe gati dëfrimin më të madh që ata kanë në jetën e tyre mizerje. Përderisa për kryebashkiakun seksi nuk përbën asnjë rëndësi vitale derisa nuk politizohet! Ky mendon se burrat e këtij qyteti kamuflohen në lloj-lloj formash dhe hyjnë tinëz në këto bordele dhe sallone kurvash. Ky politikan i rryer mendon se burrat e këtij qyteti i kanë shumë frikën edhe policisë, prandaj ata fshehurazi futen sikur klandestinë nëpër këto shtëpi kurvash dhe bëjnë çdo gjë që është e mundur për t'u kamufluar e të mos kapen. Më vjen keq, por kjo s'është ashtu. Këta burra të thjeshtë të qytetit pas punës shkojnë te dritarja e këtyre shtëpive, presin biletën sikurse në bordelet e garave të qenve, presin në radhë derisa t'ju vijë rendi të fitojnë çmimin e madh. Çka bën kryebashkiaku me këtë gjest të dhunshëm është që i bën që këto gra të vuajnë për bukën e gojës dhe, po ashtu, këta burra mbesin të përjashtuar nga e drejta e tyre konsensuale për t'u kënaqur dhe dëfryer. Një ligj dhe fushatë e tillë i shtyn këto dy kategori të qytetarëve të Nju-Jorkut të marrin masa të jashtëzakonshme në mënyrë që të mbijetojnë.

Yuri më kumton nëpërmjet telefonit se masat e kryebashkiakut e kishin shtyrë atë të ndërrojë adresë dhe të lëvizë nga "Zonja me fat" te "Shërbyeset e lumtura", por edhe aty gangsterët e kryebashkiakut e kishin përzënë atë nga ajo shtëpi dhe pas dy javësh me shumë keqardhje mora lajmin se Yuri ishte kthyer tashmë në Japoni.

Sa më shkoj shumë në nerva kjo punë. Pse ky burrë i brishtë kryebashkiak nuk më le rehat jetën time seksuale!? Do të kisha shumë më tepër respekt për këtë politikan po qe se më le rehat që ta kënaq veten.

Të katër shërbyeset në shtëpinë "Shërbyeset e lumtura" ishin një nga katër kurvat më namrudet që kam parë ndonjëherë në jetën time. Të gjitha ishin edhe të vrazhda. Por, pasi që i kisha depozituar dhjetë dollarët e parë, e zgjodha njërën pak më të mirë dhe ajo menjëherë më futi në një dhomë që nuk kishte krevat.

"Zhvishu" – më tha ajo dhe menjëherë braktisi dhomën.

Unë po shikoja përreth. Dhoma ishte sikur një stallë kafshësh. Yuri kur ishte këndej dhomën e kishte shumë më të madhe, me krevat të madh, me pasqyrë të madhe dhe ajo ishte një dhomë e ndritshme. Yuri kishte, po ashtu, edhe disa piktura të varura në mur. Ajo dukej sikurse një shtëpi tamam. Nxora qafën jashtë dhomës dhe i thashë asaj zonjës se si është e mundur që nuk ka krevat?

"Zhvishu!" – më thotë ajo prapë. "Nuk ka krevat". Kjo do të vazhdonte krejt natën kështu, por të hapni shtëpi kurvash e të mos keni asnjë krevat, kjo është shumë e marrë. Çka unë nuk e kisha kuptuar atëherë ishte se kjo nuk ishte ide e tyre, por e kryebashkiakut. Pasi që kryebashkiaku kishte dështuar në misionin e tij të ndalimit të prostitucionit me anë të shantazhimit dhe linçimit të burrave, ai kishte ndryshuar taktikë; kjo ishte për t'u mos besuar.

Dritat te shtëpia "Gruaja me fat" ishin ende të ndezura dhe unë shkova një ditë. Pagova pesëmbëdhjetë dollarë dhe prita. Vendi kishte ndryshuar tej mase. Ishte krejt tjetër. Aty ata kishin ndërtuar një podium ku gratë e zhveshura hapnin këmbët, me kurriz të zbuluar dhe me gjinjtë e saj jashtë kërcenin nën tingujt e muzikës rok. Një numër i madh i Gjonve të mbledhur aty po injoronin vajzat dhe ata më shumë dukeshin sikur aplikues të mirëqenies sesa burra që vinin për t'u dëfryer. Isha ulur afër një të riu dhe po e pyesja se ç'po ndodhte.

"Ata po i zënin këta njerëz ditë për ditë dhe gjithçka ishte bërë kaos!" – më thotë ai.

"Ku janë gratë?" – pyeta.

"Ato janë mbrapa skenës. Prit radhën!" – më përgjigjet ajo.

Një grua e gjatë, e tëra e veshur mirë, po afrohej me një kovë plastike me ujë.

"Çfarë mënyre e keqe për ta drejtuar një biznes të tillë!" – thashë me vete.

"Ule zërin e mos bërtit" më thotë gruaja e gjatë. Kaq ishte për mua. I ngrati kisha prerë biletën pesëmbëdhjetëdollarëshe dhe kisha bërë gjithë këtë shpenzim dhe vjen kjo e më urdhëron që ta mbyll gojën. I thashë të shkoj në të së ëmës.

"Mos më fol me atë gjuhë mua!" më thotë si më bezdi. "Unë jam një grua!" më thotë ajo. Unë ia përsërita edhe një herë që të ikte në të së ëmës dhe ajo pa një pa dy thërret sigurimin. "Ah, jo bre!" – thashë me vete.

"Të lutem, ule zërin doktor" – më thotë një burrë i sigurimit.

"Po shpresoj që bile të këtë krevat!" – i them atij.

"Jo. S'ka më krevat!" – ma kthen ai i sigurt në atë që thotë.

"Po unë nuk po kuptoj pse" – i them atij.

"Krejt çfarë bëjnë tashti është të improvizojnë me krevat kampingu. Dhe kaq!"

U ngrita. Sapo kisha harxhuar njëzet e pesë dollarë. Tash isha në gjendje t'i harxhoj edhe njëzet e pesë të tjera. "Më mirë po i hedh këto të holla!" i thashë aty një gocës që nuk kishte fare gjinj dhe më shumë dukej si një ketër e vogël e pa zhvilluar mirë sesa që ta çonte mallin e një kurve. Ajo po rrinte te dera e daljes.

Pas dy ditësh telefoni im binte zile.

"Tung Ne'son!"

"Unë mendova se je në Japoni!" – i thashë asaj.

"Isha, por tani u ktheva, jam këtu në Nju-Jork!"

Nëse mendon se unë do t'jua zbulojë adresën e saj të re, ju do të ishit jashtë mendjes suaj.

Një gjë që kuptova pastaj ishte se emri i saj nuk ishte Yuri.

*Përktheu: Emanuel Bajra*




# Sport


Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Fillon edicioni i katërt i projektit 'Elite Youth Development Programme U15'



Prishtinë, 13 prill - Ka filluar edicioni i katërt në kuadër të projektit "Elite Youth Development Programme U15". Edhe sivjet ky projekt do të zhvillohet me përfshirjen e të gjitha regjioneve, me rreth 600 futbollistë të grupmoshës nën 15 vjeç, të cilët do të vlerësohen për performancën e tyre nga trajnerët e angazhuar në këtë program si dhe do të vëzhgohen nga afër edhe nga trajnerët e ekipeve zinxhirë të kombëtares. Krahas aktiviteteve në Kampin Nacional në Hajvali, ky projekt do të realizohet edhe nëpër regjione, ku do të zhvillohen ndeshje në formë turneu.
Përgjegjësi i projektit, Edmond Rugova, ka vlerësuar shumë të rëndësishëm vazhdimësinë e këtij programi, në të cilin sivjet janë të përfshirë futbollistët e lindur në vitin 2009. "Është kënaqësi të fillosh sërish këtë program dhe shpresoj se ashtu siç është krijuar do të ketë vazhdimësi edhe në vitet e ardhshme. Posa të përfundojmë përzgjedhjet e lojtarëve në fazën e parë, do të krijohen ekipet rajonale, mandej vazhdojmë me turne ndërrajonale, ku trajnerët do të kenë mundësi t'i shohin këta lojtarë edhe në ndeshjet në formë turneu", ka theksuar Rugova.
Ai është shprehur i entuziazmuar për numrin e madh të talenteve, por ka thënë se duhet një qasje më serioze në punën me këta djelmosha. "Esenca e këtij projekti është zhvillimi dhe ngritja e cilësive individuale në konceptin ekipor. Ky program është i dizajnuar për ta ngritur nivelin e cilësisë së secilit futbollist të përfshirë. Njëherësh ky program është në koordinim edhe me seleksionimet që po bëhen jashtë vendit siç është kampi i fundit në Grunberg të Gjermanisë", ka shtuar Rugova. Ai ka bërë me dije se në shtator apo tetor planifikohet të nisë puna edhe me gjeneratën e lindur në vitin 2010. Të lumtur që janë pjesë e këtij projekti janë shprehur edhe futbollistët e rinj, të cilët e kanë mundësinë t'i tregojnë vlerat e tyre para trajnerëve të të gjitha regjioneve, derisa kanë folur edhe për ëndrrat e tyre në të ardhmen. "Jam shumë i kënaqur që e kam nderin të luaj këtu dhe ta shpreh talentin tim. Në të ardhmen kam dëshirë të bëhem futbollist profesionist dhe të luaj në ekipe të mëdha", ka thënë Bardh Kryeziu nga ekipi i FC Ballkanit.
Edhe anëtari i FC Dragashi, Dren Loshaj, është shprehur: "Jam i lumtur që jam pjesë e këtij projekti. Shpresoj të përzgjidhem për ekipin e regjionit dhe në të ardhmen edhe për ekipin kombëtar. Ëndrra ime është të arrij sa më shumë në futboll dhe të luaj në ndonjë prej shteteve më të avancuara si Angli apo Gjermani".

## SHKURT

### Rashica edhe një vit te Galatasaray

Reprezentuesi i Kosovës, Milot Rashica, pritet të jetë pjesë e Galatasarayt së paku edhe një vit. Rashica po shkëlqen në Turqi, ndërsa është i huazuar për një sezon nga Norwichi. Sipas mediumit turk "Fanatik", klubet tashmë janë marrë vesh që 26-vjeçari të mos kthehet në "Carrow Road" në verën që vjen. Javët në vazhdim do të vendoset përfundimisht nëse Norwichi do ta shesë përfundimisht futbollistin ofensiv, apo do t'ia japë Galatasarayt hua edhe për një vit. Vlera e ish-lojtarit të Vushtrrisë është rreth 10 milionë euro.

### Vinicius: Ancelottin e dua te Brazili

Vinicius Junior ishte ndër lojtarët më të mirë në fushë në ndeshjen e fituar 2-0 ndaj Chelseat. Sulmuesi brazilian ishte protagonist në dy golat me asistimet e tij. Në prononcimin pas ndeshjes, Vinicius lëshoi mesazhe dashurie për Realin dhe trajnerin Carlo Ancelotti. "Do të doja të qëndroja përgjithmonë te Reali: klubi më i mirë në planet. Është emocion i veçantë të luash në Ligën e Kampionëve. Ancelotti? Për mua ai është trajneri më i mirë në botë. Do të doja të ishte trajneri im te Reali dhe te Brazili", ka thënë braziliani.

### Grushtimi ndaj Sanes, Bayerni dënon Manen

Skuadra e Bayern Munchenit përmes rrjeteve sociale ka bërë me dije dënimin e dhënë për lojtarin e Kombëtares së Senegalit, Sadio Mane. Mane është lënë jashtë grumbullimit për ndeshjen e javës së 29 në Bundesliga, ku bavarezët luajnë ndaj Hoffenheimit. Sulmuesi senegalez merr edhe një gjobë, por që nuk është bërë me dije shuma nga skuadra gjermane. Kujtojmë që ky dënim vjen për shkak të sjelljes josportive të Manes në ndeshjen e parë çerekfinale në UEFA Champions League ndaj Manchester Cityt. Madje u raportua se ish-lojtari i Liverpoolit, Mane, goditi me shuplakë bashkëlojtarin e tij, Leory Sane.

## Shabani: Kosova ka bërë hap para



Prishtinë, 13 prill - Përzgjedhësi i Kosovës në Hendboll, Agron Shabani, ka vlerësuar rritjen e përfaqësueses pas ndeshjes së dytë me Poloninë. Kosova nuk u kualifikua në Botëror, por i pret me optimizëm kualifikimet për Evropian. "Kemi pasur përballë një kombëtare të nivelit të lartë evropian. Kualiteti ishte shumë më i lartë se yni. Jemi angazhuar maksimalisht, por nuk e përballuam nivelin e kundërshtarit. Do të përpiqemi tash për Evropian të mobilizohemi maksimalisht dhe të japim më të mirën. Kemi bërë një hap të madh para, kemi ardhur deri në këtë lojë dhe do të përpiqemi të bëjmë edhe më mirë sesa që kemi bërë deri tash", ka thënë Shabani.

## Klubet e Premierligës nuk do t'i përdorin emrat e kompanive të basteve në fanella

LONDËR, 13 PRILL - Klubet e Premierligës janë marrë vesh bashkërisht që të heqin dorë nga përdorimi i emrave të kompanive të basteve në fanellat e tyre. Janë tetë klube aktuale të Premierligës që në fanellat e tyre prapa i kanë sponsorë kompanitë e basteve, duke i fituar rreth 60 milionë funte në vit, shkruan "Sky Sports". Ky ndryshim do të nisë së aplikuari që nga fillimi i sezonit 2026/27, kur do të përfundojnë edhe krejt kontratat aktuale të klubeve me sponsorët aktualë të fanellave. Premierliga, në një njoftim të saj, tha se është bërë liga e parë sportive në Britaninë e Madhe që e merr një vendim të tillë, në bashkëpunim me "aminin" e krejt klubeve të saj, për heqjen e kompanive të basteve nga fanellat. Premierliga njoftoi, po ashtu, se është duke punuar me sportet e tjera në zhvillimin e kodit të ri për sponsorizimin e përgjegjshëm nga lojërat e fatit.



# Zyrtari i FIA-s: Verstappeni më i pamëshirshëm se Hamiltoni, kërkon t'i 'shkatërrojë' kundërshtarët

HASSELT, 13 PRILL - Max Verstappeni e ka nisur sezonin e ri të Formulës 1 ashtu si e mbylli atë të kaluarin. Holandezi ka fituar dy gara nga tri të zhvilluara teksa në njërën prej tyre u rendit në vendin e dytë duke u konfirmuar pretendenti kryesor për triumfin final. 25-vjeçari njihet për mënyrën agresive të të pilotuarit dhe së fundmi, zyrtari i Federatës Ndërkombëtare të Automobilizimit (FIA), Tom Clarkson, u shpreh se dy herë kampioni i botës është edhe më i pamëshirshëm se Lewis Hamiltoni. "Verstappeni në këtë sezon është shumë i shpejtë dhe kjo është e dukshme. Unë nuk kam njohur kurrë një pilot aq të uritur për sukses sa Verstappeni. Uria për sukses është shumë e rëndësishme në Formula 1, lidhet me mentalitetin. Ky është çelësi për mua dhe në këtë pikë Verstappeni është i ngjashëm me Sennan apo Schumacher. Janë njerëz të cilët kanë fituar shumë në këtë sport. Në pistë, Verstappeni është i pamëshirshëm. E di që shumë njerëz e kanë të vështirë ta kuptojnë këtë sepse në jetën e përditshme diçka e tillë quhet egoizëm dhe është diçka jo fort e bukur, por kur vjen puna te një sport, atëherë është thelbësore që ta marrësh maksimumin dhe të mos i lejosh të tjerët të të afrohen. Është një mentalitet i domosdoshëm nëse kërkon të kesh sukses. Objektivi nuk është të dukesh i bukur në pistë, por të fitosh. Dhe pikërisht këtë po bën Verstappeni", ka thënë ai. "Këtë e ka trashëguar nga prindërit. Mamaja e tij ishte pilote në Go-Cart, ndërsa babai në Formula 1. Jam i sigurt se gjatë kohës kur Max rritej, prindërit janë siguruar ta mësojnë se të praktikosh këtë sport vetëm për qejf nuk është mjaftueshëm. Nëse je në Formula 1 do të duhet të fitosh, nuk ka rrugë tjetër. Dhe Verstappeni jo vetëm që fiton, por kërkon edhe t'i shkatërrojë kundërshtarët. Mjafton ta përmendim garën në Arabinë Saudite. U nis nga vendi i 15-të dhe përfundoi në vendin e dytë, por nuk ishte i kënaqur. U shpreh qartë se objektivi i tij nuk është asnjëherë vendi i dytë, ndërsa një pilot tjetër në vendin e tij do të kishte bërë festë. Sergio Perez u gëzua për një vend të pestë. Unë nuk e imagjinoj Verstappenin të qeshë nëse e mbyll një garë në vendin e pestë. Mentaliteti i tij është unik. Është një fitues serial. Edhe Hamiltoni e Leclerci kanë dëshirën e Verstappenit, por holandezi ka diçka më shumë, diçka që unë nuk e shoh te pilotët e tjerë. Nuk mërzitet nga fitoret dhe kërkon gjithnjë më shumë dhe për mua nuk ka asnjë dobësi. Për mua është e frikshme të mendoj se sa i mirë mund të bëhet Verstappeni me kalimin e kohës", u shpreh Clarksoni.




# Spalletti: Milani, skuadër e mrekullueshme, gjyqtari e teproi me kartonin e kuq

TORONTO, 13 PRILL - Janë luajtur dy ndeshjet e radhës së fazës "play-in". Në fushë kanë zbritur skuadrat e renditura në vendet 9-10 në konferencat përkatëse. Kështu, në Lindje, ekipi i Chicago Bullsit mundi 109-105 Toronto Raptorsin jashtë fushës, në një ndeshje me rivalitet deri në fund. Ekipi kanadez nuk përfitoi nga faktori fushë edhe pse Siakami realizoi 32 pikë, duke u eliminuar nga gara për titull. Për Chicagon u dallua LaVine me 39 pikë. Bullsi, në ndeshjen tjetër të "play-in", do të përballet me Miami Heatin për ta siguruar biletën e fundit në "play-off" në Lindje. Në Perëndim, ekipi i Oklahoma City Thunderit fitoi 123-118 ndaj New Orleansit, në një ndeshje spektakolare dhe plot emocione. Për Oklahomën u dalluan Shai me 32 pikë e Giddey me 31 pikë, teksa ndeshjen tjetër të "play-in" do të luajnë ndaj Minnesotas, ndërsa New Orleansi eliminohet.



## SHKURT

### Lampardi: Pres diçka speciale në 'Stamford Bridge'

Trajneri i Chelseat, Frank Lampard, është ndarë i kënaqur me paraqitjen e skuadrës së tij ndaj Real Madridit, ani pse humbi me rezultat 2-0. Lampardi beson se skuadra e tij mund të dhurojë diçka speciale në ndeshjen e kthimit në "Stamford Bridge". "Jam krenar për atë që bëmë për sa kohë ishim 11 kundër 11. U thashë djemve se në 'Stamford Bridge' mund të ndodhë diçka speciale. Real Madridi ka një skuadër shumë të mirë, por ne duhet të besojmë", ka thënë Lampardi për "BT Sport".

### Ancelotti: Ishim të përkryer, njëjtë duhet të jemi edhe në Londër

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, analizoi sfidën e parë përballë Chelseat, një ndeshje që në sytë e tij ekipi e interpretoi në mënyrë të përkryer. "Zhvilluan një ndeshje të përkryer këtu, por duhet ta përsëritim edhe në 'Stamford Bridge' për t'i siguruar gjysmëfinalet. U futëm në fushë me objektivin për të siguruar një avantazh të rëndësishëm dhe ia arritëm. Chelsea ka një skuadër të mirë dhe në disa çaste na vë në vështirësi. Gjithsesi, në futboll mund të ndodhë çdo gjë dhe duhet të administrojmë mirë këtë avantazh. Valverde? Më shumë mundësi ishte më i miri në fushë", ka deklaruar Ancelotti.

### Pioli: Jam i lumtur për fitore, na pret një ndeshje e komplikuar

Milani e fitoi ndeshjen e parë çerekfinale ndaj Napolit (1-0), por trajneri Stefano Pioli ka thënë se skuadrën e tij e pret një ndeshje e komplikuar për të arritur në gjysmëfinale. "Nuk mendoj se kishte dëshirë nga ana e Napolit për hakmarrje. Napoli na sulmoi pak më shumë, ne u desh të luanim me topa të gjatë. Na sulmoi më shumë, por ne e bëmë një lojë serioze me kujdes, kualitet dhe energji. Askush nga ne nuk mendon se e kemi kaluar turnin. Na pret një ndeshje e komplikuar dhe e ekuilibruar, siç kanë qenë gjithmonë ato mes nesh dhe Napolit", ka deklaruar Pioli për "Milan TV". "Napoli, edhe pse nuk e kishte sulmuesin, i kishte rastet e veta. Maignan ka bërë punë të mirë. E ka sulmin më të mirë, por ne duhet të bëjmë më mirë. E kemi mbrojtjen më të mirë në pesë ndeshjet e fundit. Është një kundërshtar me kualitet të lartë dhe mund të vuajmë edhe në Napoli. Sidoqoftë, edhe ne i kemi kualitetet tona", ka shtuar Pioli.

### Mbappe: Dua ta fitoj Ligën e Kampionëve me PSG-në

Kylian Mbappe tregon përkushtim ndaj klubit të tij aktual, Paris Saint-Germain. Në një intervistë për kanalin France 3 la të kuptohet që edhe sezonin e ardhshëm do të jetë në gjigantët francezë. "Hapi tjetër? Ta fitoj Ligën e Kampionëve. Ku? Te PSG. E kam luajtur tashmë një finale, disa gjysmëfinale, një çerekfinale, 1/8… Unë jam parisien dhe kam kontratë", ka thënë Mbappe, duke u vënë kapak thashethemeve për një largim të mundshëm nga kryeqyteti francez verën e ardhshme. Sulmuesi francez, 24-vjeçar, e ka rinovuar kontratën vitin e kaluar me kohëzgjatje deri në qershor 2024. Gjithashtu, ka opsionin për ta rinovuar kontratën edhe një sezon tjetër.

## Chicago mposhti Torontón, fiton edhe Oklahoma

TORONTO, 13 PRILL - Janë luajtur dy ndeshjet e radhës së fazës "play-in". Në fushë kanë zbritur skuadrat e renditura në vendet 9-10 në konferencat përkatëse. Kështu, në Lindje, ekipi i Chicago Bullsit mundi 109-105 Toronto Raptorsin jashtë fushës, në një ndeshje me rivalitet deri në fund. Ekipi kanadez nuk përfitoi nga faktori fushë edhe pse Siakami realizoi 32 pikë, duke u eliminuar nga gara për titull. Për Chicagon u dallua LaVine me 39 pikë. Bullsi, në ndeshjen tjetër të "play-in", do të përballet me Miami Heatin për ta siguruar biletën e fundit në "play-off" në Lindje. Në Perëndim, ekipi i Oklahoma City Thunderit fitoi 123-118 ndaj New Orleansit, në një ndeshje spektakolare dhe plot emocione. Për Oklahomën u dalluan Shai me 32 pikë e Giddey me 31 pikë, teksa ndeshjen tjetër të "play-in" do të luajnë ndaj Minnesotas, ndërsa New Orleansi eliminohet.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
***MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË***
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**
***AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE***
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Numër: 311/1
Datë: 13.04.2023

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës se Kosovës nr. 7/26 Mars),në bazë të Ligjit Nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë shpall:

# Ftesë për ofertë

***Për ekskursion të maturantëve të Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë, në Republikën e Shqipërisë.***

***Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.***

***Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:***

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjensioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Durrës (prej 26 deri 30 Prill 2023).
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës.
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të posedojë referencat nga organizimet e llojit të njëjtë në të kaluarën.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

***Kushtet tjera:***

- *Nisja duhet të bëhet më dt. 26.04.2023 dhe kthimi më dt. 30.04.2023,*
- *Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.*
- *Në të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.*
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).*
- *Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër, Berat, Vlorë.*

***Vlerësimi i ofertave:***

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Agjencinë AAAPARr-së në Prishitnë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve dhe numri
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në AAAPARr në të njëjtën ditë.
Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuara ti dorëzojnë në Agjencinë e AAAPARr-së në Prishitnë rruga "Agim Ramanadani" ndërtesa MAShT II kati i tretë, gjatë orarit zyrar 08:00-16:00.
Hapjën e ofertave e bënë Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2016.
Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjencionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotëson kriteret e caktuara nga KDSH-ja.
Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesionale dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës.
Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë) , ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.
Vërejtje: Secili ofertues duhet të aplikojë vetëm me një ofertë

**Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet po atë ditë në zyrën Qendrore të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimit Profesionale dhe Arsimit për të Rritur.**

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

TREPÇA

Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 13.04.2023 bënë shpallje publike:

**NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-06**

| | |
|---|---|
| Qëllimi i ofertës: | Dhënie me qira e restorantit të punëtorëve (Depo) në njësisë biznesore Industria Kimike. |
| Kriteret e Dhënies: | Çmimi më i lartë |
| Numri i ofertave të pranuara: | 1 (një) |

**ME KONTRATË SHPËRBLEHET**

Loti 1 Çmimi 250.00 €/Muaj – SHIJO- shpk

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 24.04.2023 ora 10:00

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtarë**: *Trepça sh.a.* | | |
| **Adresa postare**: *Parku inustrial* | | |
| Qyteti: *Mitrovicë* | Kodi postarë: *40000* | Shteti: *Kosovë* |
| **Kontakti**: *Burim HAJDINI* | | Telefoni: *+383 (0) 28 538 050* |
| Email: *hajdini_b@hotmail.com* | | Faksi: *+383 (0) 28 539 202* |
| *www.trepcacorporation.com* | | |

*Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.*

---

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Labena" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811927493 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Labena" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810128498 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Labena" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810128498 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**
**Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat**

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2023 të datës 23 Shkurt 2023, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

**K O N K U R S**

**I. Referent i Lartë**
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Mitrovicë, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Gjakovë, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Pejë, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 005 |
| Emri Pozitës: | Referent i Lartë |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional 2 |
| Raporton tek: | Udhëheqës i Shkrimores |
| Numri i pozitave: | Pesë (5) pozita |
| Klasa: | P 15 |
| Koeficienti: | Pesë pikë tre (5.3) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | Dymbëdhjetë (12) muaj |
| Vendi: | Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike lidhur me lëndët e pranuara në njësinë organizative ku është punësuar, mban evidenca të sakta dhe me kohë në regjistrin e regjistrimit të lëndëve dhe regjistrin e çregjistrimit të lëndëve sipas kërkesave të specifikuara të vetë regjistrit, kujdesi për lëndët dhe shkresat e lëndëve.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Regjistron me kohë lëndët në regjistrin e pranimit të lëndëve me të gjitha të dhënat që kërkohen sipas regjistrit duke mbajtur evidenca të sakta të lëndëve dhe shkresave të lëndës duke e mbajtur edhe evidencën elektronike;
Çregjistron lëndët dhe mbanë evidenca të sakta në regjistrin përkatës dhe në mënyrë elektronike, mbanë evidenca për lëndë specifike dhe të rëndësisë së veçantë, duke vepruar me vetë-iniciativë dhe pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë;
Përgjegjës për afate dhe saktësi të punës;
Mbikëqyrë sistemin e përcjelljes së lëndëve dhe menaxhon me lëndët sipas punës së ngarkuar;
Kontrollon lëndët dhe lëvizjen e tyre brenda institucionit, duke qenë në gjendje që në çdo kohë ta sigurojë lëndën për përfaqësim në Gjykatë;
Mbanë evidenca të sakta e të plota lidhur me dosjet dhe shkresat e lëndëve, akteve, shkresave dhe dokumenteve tjera zyrtare, përfshirë edhe përgatitjen e raporteve për punën e kryer në periudha të caktuara raportuese;
I gatshëm për kryerjen e çdo detyre tjetër si referent në shkrimore në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale;

Kryen edhe punë tjera të lidhura me punën e referentit të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Shkathtësi të mirë komunikimi me shkrim dhe me gojë;
Aftësi të rregullimit dhe të ruajtjes së kujdesshme të dosjes së lëndëve dhe shkresave;
Aftësi të punojë e pavarur dhe në mënyrë ekipore;
Shkathtësi të mira të punës me kompjuter (Word dhe Excel).
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Administratë Publike, Shkenca Shoqërore.
**Përvoja e Punës:**
Dy (2 ) vite përvojë pune profesionale.

**II. Zyrtar i Burimeve Njerëzore për Paga**
Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/ POZ – 006 |
| Emri pozitës: | Zyrtar i Burimeve Njerëzore për Paga |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional 2 |
| Raporton tek: | Udhëheqësi i Zyrës për Paga |
| Numri i pozitave: | Një (1) pozitë |
| Klasa: | P 15 |
| Koeficienti: | Pesë pikë tre (5.3) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | Dymbëdhjetë (12) muaj |
| Vendi: | Prishtinë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Menaxhimi i pagave për tërë stafin e sistemit prokurorial sipas ligjeve dhe akteve ligjore ne fuqi.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Zbaton aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e personelit në Këshill dhe Prokurorin e Shtetit;
Ndihmon ne hartimin e planeve e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë;
Përgatit të gjithë formularët për paga, shtesat për tërë sistemin prokurorial dhe kompensimet tjera;
Analizon dhe është përgjegjës për hartimin e raporteve sipas veprimtarisë në fushën e pagave, shtesat në pagë dhe kompensimet tjera;
Përgjegjës për sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore (SIMBNJ);
Përgjegjës për verifikim te vijueshmërisë se tërë stafit në sistemin prokurorial dhe përgatit raporte te vijueshmërisë se stafit;
Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e pagave, shtesave në pagë dhe kompensimet tjera;
Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me shërbimin civil;
Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik.
**Përvoja e Punës:**
Dy (2) vit përvojë pune profesionale.

**III. Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave**
Prokuroria Themelore në Gjakovë, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ – 007 |
| Emri pozitës: | Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional 2 |
| Raporton tek: | Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim |
| Numri i pozitave: | Një (1) pozitë |
| Klasa: | P 15 |
| Koeficienti: | Pesë pikë tre (5.3) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | Dymbëdhjetë (12) muaj |
| Vendi: | Gjakovë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Zhvillimi dhe shpërndarja e komunikimeve për të informuar qytetarët, institucionet për politikat, shërbimet dhe arritjet e prokurorive të Kosovës , për të rritur dhe mbrojtur reputacionin e Prokurorit të Shtetit dhe kontribuar në rritjen e nivelit të komunikimit dhe informimit për qytetarët dhe institucionet e Kosovës.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Koordinon aktivitetet për komunikim me publikun në prokurorinë përkatëse;
Siguron qasje dhe transparencë të punës së prokurorisë përkatëse, nëpërmjet ofrimit të informacioneve dhe dokumenteve për opinionin publik dhe mediat;
Jep informata të nevojshme lidhur me punët e prokurorisë përkatëse;
Siguron aplikimin e standardeve të komunikimit publik, nëpërmjet trajnimit dhe avancimit, me qëllim që puna e tij të ushtrohen në mënyrën më efektive dhe efikase;
Bashkëpunon me zyrtarët për komunikim publik të Prokurorit të Shtetit, Këshillit Prokurorial dhe gjitha prokurorive;
Zëvendëson sipas nevoje zyrtarët për komunikim të prokurorive:
Siguron hartimin dhe zhvillimin e politikave të fjalimeve dhe opinioneve për të gjitha temat e rëndësishme lidhur me aktivitet dhe shërbimet e prokurorisë përkatese;
Bën vlerësim të rregull të komunikimit me media të prokurorisë përkatëse.
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Njohuri në fushë-veprimtarinë dhe kompetencat e sistemit prokurorial;
Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik;
Njohuri për përdorimin e kompjuterit (Internet, E-email, Word, Pover Point);
Shkathtësi të lartë në organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
Fleksibilitet ndaj organizimit të punës.
E prëferueshme gjuha Angleze
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi**:
Diplomë Universitare - Fakulteti i Gazetarisë ose Shkencat Shoqërore.
**Përvoja e Punës:**
Dy (2) vit përvojë pune profesionale.

**IV. Zyrtar për Përkthime (shqip- serbisht dhe anasjelltas)**
Prokuroria Themelore Gjilan, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 008 |
| Emri pozitës: | Zyrtar për Përkthime |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional 2 |
| Raporton tek: | Administratori i Prokurorisë |
| Numri i pozitave: | Një (1) pozitë |
| Klasa: | P 15 |
| Koeficienti: | Pesë pikë tre (5.3) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | Dymbëdhjetë (12) muaj |
| Vendi: | Gjilan |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike për stafin Profesional të një njësie organizative në fushën kryesore të punës, për përkthimin e të gjitha materialeve, duke siguruar përkthim cilësor.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Bën përkthim profesional të materialeve të shkruara nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;
Bën përkthim profesional simultan në takimet e ndryshme;
Përgjegjës për respektimin e afateve dhe për saktësinë e përkthimeve që kryen;
Merr përgjegjësi specifike lidhur me përkthimin e materialeve që kërkohen nga institucioni;
Është përgjegjës për përkthimin e dokumenteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit te njëjtave;
Kontrollon/Lekturon materialet e përkthyera dhe është përgjegjës për përkthim cilësor, si me shkrim, konsekutiv dhe simultan;
Mbanë evidencën e saktë e të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, përfshirë përgatitjen e raporteve për tërë punën e kryer;
Kryen edhe detyra tjera të punës në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Shkathtësi të shkëlqyera të njohjes së gjuhës gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim;
Njohuri të mirë në të shkruar të gjuhës Shqipe dhe Serbe;
Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel).
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi**:
Diplomë Universitare.
**Përvoja e Punës:**
Dy (2) vite përvojë pune.

**V. Zyrtar për Arkiv 1**
Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 009 |
| Emri pozitës: | Zyrtar për Arkiv 1 |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional 2 |
| Raporton tek: | Administratori i Prokurorisë |
| Numri i pozitave: | Një (1) pozitë |
| Klasa: | P 15 |
| Koeficienti: | Pesë pikë tre (5.3) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | Dymbëdhjetë (12) muaj |
| Vendi : | Prishtinë |

**Qëllimi i vendit të punës:**

Arkivimi, sistemimi dhe mbajtja azhure e lëndëve të institucionit.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në arkivin e institucionit në përputhje me procedurat ligjore;
Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;
Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;
Mbanë kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;
Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën dhe shpërndarjen e postes, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata ,dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel).
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Diplomë Universitare.
**Përvoja e Punës:**
Dy (2) vite përvojë pune.

**VI. Zyrtar për Distribuimin e Dokumenteve 1**
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Mitrovicë, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Gjilan, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Ferizaj, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 010 |
| Emri pozitës: | Zyrtar për Distribuimin e Dokumenteve 1 |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Teknik dhe Mbështetës 2 |
| Raporton tek: | Administratori i Prokurorisë |
| Numri i pozitave: | Pesë (5) pozita |
| Klasa: | P 18 |
| Koeficienti: | Tre pikë nëntë (3.9) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | Dymbëdhjetë (12) muaj |
| Vendi : | Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Bënë dërgimin e të gjithë shkresave, postës dhe dokumentacionit hyrës dhe dalës nga Institucioni për institucionet tjera dhe palët.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Përgjegjës për shpërndarjen me kohë të postës dhe shkresave të ndryshme të Institucionit në institucionet tjera dhe tek palët;

Mban evidencat lidhur me pranimin -dorëzimin e postës dhe ruan konfidencialitetin (fshehtësinë e lëndëve);
Kujdeset që ftesat e institucionit të dorëzohen tek personi i caktuar në ftesë, ose tek familja në bazë të procedurave të parapara për dorëzimin e tyre;
Përgatitë postën, rregullon evidencat dhe raportet;
Përgjegjës për sjelljen e tij me palët dhe personelin e institucioneve;
Sipas nevojës kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të drejtpërdrejtë;
Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen nga udhëheqësi.
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Aftësi të mjaftueshme që herë pas here të merret me disa çështje të cilat nuk janë paraparë me udhëzime, por që lidhen me nevojat e institucionit;
Shkathtësi komunikimi me stafin e të njëjtit nivel brenda institucionit;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel ) .
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Shkolla e mesme.
**Përvoja e Punës:**
Tri (3) vite përvojë pune.

---

- *Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetat ditore, duke filluar nga data **14.04.2023 deri me datë 28.04.2023** si datë e mbylljes së konkursit.*
- *Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org*
- *Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.*
